



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

16-03-2021

Ref. 2103/330/KPM/xhl.

TE7

Berat Buzhala
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/41 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TE7 (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin Nr.03/L-073 për Zgjedhje e Përgjithshme, Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
2. Me datën 26 janar 2021 KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore gjatë Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
3. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka bërë monitorimin e këtij ofruesi të shërbimeve mediale gjatë heshtjes zgjedhore dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 14 shkurt 2021, ka gjetur se Pala Përgjegjëse konkretisht në ditën e zgjedhjeve me datën 14 shkurt 2021 ka transmetuar deklaratën e kandidatit nga PDK, z. Enver Hoxhaj, pas votimit të tij, përmbajtja e së cilës ka elemente të mesazhit politik në lidhje me zgjedhjet, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet.
4. KPM me datën 14 shkurt 2021 i ka dërguar Njoftim për shkelje Palës Përgjegjëse dhe e ka njoftuar për shkeljet e bëra, si dhe ka kërkuar që të veprojnë në pajtueshmëri me Kreun e VIII të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke ndërmarrë veprime të menjëhershme që shkeljet e tilla mos të përsëriten.

Analiza ligjore

5. Përmes kësaj, Komisioni i Pavarur i Mediave konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, i cili përcakton se:

“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.”


6. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM ka konstatuar se Pala Përgjegjëse gjatë heshtjes zgjedhore, konkretisht në ditën e zgjedhjeve me datën 14 shkurt 2021, ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet, ka transmetuar deklaratën e kandidatit nga PDK, z. Enver Hoxhaj, pas votimit të tij, përmbajtja e së cilës ka elemente të mesazhit politik në lidhje me zgjedhjet.
7. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

Vendim

8. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej pesë mijë (5.000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 për shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

9. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
10. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LAVIFI
Kryetar



16.03.2021
Datë